



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0069482-2/24 dt. 30.10.2024
Mitrovicë



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 2 dhe 4 të Rregullores Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2024, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0067951-2/24 dt. 23.10.2024); miratoi këtë:

VENDIM

Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025

1. Miratohet vendimi për SHPALLJEN e Konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi shpallet konkursi për ndarjen e 300 bursave për studentë, në shumë mujore prej shtatëdhjetë (70) €, të cilat ipen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 qershor.
3. Nga numri i përgjithshëm i ndarjes së bursave, 10 bursa do t'u ipen studentëve nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Mitrovicës, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me konkurs, respektivisht Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
4. Kriteret për realizimin e së drejtës për bursë përcaktohen në bazë të Rregullores Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
5. Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave formohet Komisioni nga Kuvendi i Komunës në përbërje:
 - 5.1 Fisnik Krasniqi
 - 5.2 Jeton Zeneli
 - 5.3 Gazmend Asllani,
 - 5.4 Drita Kadriu, dhe
 - 5.5 Igballe Islami.
6. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë kërkesat, të bëjë vlerësimin e tyre duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs dhe në harmoni me Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
7. Studentët që fitojnë bursën do të lidhin kontratë që nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i bursës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Komisioni i formuar me pikën 5 të këtij vendimi.
9. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të emëruar